



Data: 29/07/2019

Ref.: 158/1190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Dizajn inxhinierik dhe automjete, BSc 180 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programit të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike më datë 23.04.2019 me qëllim të vlerësimit të programit të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Herwig Grogger dhe Prof. Dr. Peter Sturm.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se programi i studimit Dizajn inxhinierik dhe automjete (BSc) i ofruar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike përmbushë substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët ndërkombëtar po ashtu rekomandojnë ndryshimin e emrit të programit të studimit nga "Konstruksione dhe mekanizim" siç është paraqitur në kërkesën për riakreditim në "Dizajn inxhinierik dhe automjete" për të reflektuar më saktë përmbajtjen e programit të studimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

